

Rreziku i nuskave (HAJMALIVE)

Shejh Ali ibën Jahja el Haddadi



Hutbeja e parë:

Të gjitha falenderimet i takojnë Allahut, Atë e falenderojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e veteve dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush e humbet, ndërsa atë që Allahu e humbet, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të pashok, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të, familjen dhe shokët e tij. Më pas...

Robër të Allahut! Frikësojuni Allahut ashtu siç i takon, dhe dijeni se Allahu *azze ue xhel-le* është veçuar me Rrububije; Ai është Zoti i krijesave, dhe nuk ka Zot tjetër përveç Tij që krijon, që furnizon, që jep jetë, merr jetë, sjell dobi, sjell dëm, sprovon apo jep mirëqenie. Asgjë nuk del jashtë sundimit të Tij, dhe asgjë nuk ndodh pa lejen e Tij; çfarë dëshiron Allahu bëhet, dhe çfarë nuk dëshiron nuk bëhet.

Allahu nuk i ka dhënë kujt hise në këto gjëra, as melaikeve, as peygamberëve, pa përmendur të tjerët që janë në grada poshtë tyre. Thotë Allahu i Lartësuar:

قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي ضَرًّا وَلَا نَفْعًا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ

“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu”. [El Earaf: 188].

Dhe thotë i Lartësuar:

قُلْ إِنِّي لَا أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا

“Thuaj: “Unë nuk mundem t’ju bëj ndonjë dëm e as t’ju sjell ndonjë dobi.” [El Xhinn: 21].

Allahu i Lartësuar urdhëron robin dhe të dërguarin e Tij, Muhamedin *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* që t’i lajmërojë njerëzit se ai nuk posedon për veten e tij, dhe as për të tjerët dëm apo dobi. Nëse Muhamedi *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* nuk ka patur nën posedim gjë prej tyre, a mund të mendohet se ndokush tjetër nga krijesat ka në dorë gjë? Kurrsesi!

Vërtet besimi që ka muslimani rreth këtij parimi madhështor, ia bën për detyrë që zemrën ta ketë të lidhur vetëm me Allahun; qoftë në të fshehtë apo haptazi, në të lehtë apo vuajtje, në rehati apo vështirësi. Muslimani i drejtohet Allahut, tek Ai kërkon strehim dhe tek Ai mbështetet.

Thotë Allahu i Lartësuar:

وعلى الله فتوكلوا إن كنتم مؤمنين

“Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!” [El Maideh: 23].

Poashtu thotë:

فاستعذ بالله إنه هو السميع العليم

“Kërko strehim tek Allahu, me të vërtetë Ai është Dëgjuesi dhe i Gjithëdituri.” [Fussilet: 36].

Allahu ka lëvdur Muhamedin *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* dhe shokët e tij për faktin se ata i drejtoheshin Allahut në kohë frike. Thotë i Lartësuari:

الَّذِينَ قَالَ لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ فَزَادَهُمْ إِيمَانًا وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

“(Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: “Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!” [Aal Imran: 172].

Edhe pse të kërkuarit strehim tek Allahu është teuhid, dhe të kërkuarit të saj nga dikush tjetër veç Allahut është shirk, megjithëkëtë kjo nuk e bën të ndaluar veprimin e shkaqeve të lejuara, të cilat me lejen e Allahut të mbrojnë nga të këqijat; sikurse kurimi nga sëmundja, strehimi nën hije nga dielli, të veshurit me rroba leshi kur është ftohtë, ankimi tek gjykatësi për padrejtësinë e hasur prej ndonjërit, e kështu me radhë.

Veprimi i shkaqeve të lejuara, bën pjesë tek mbështetja e plotë tek Allahu, ashtu sikurse mos-veprimi i tyre bën pjesë në cenimin e Sheriatit dhe bën pjesë tek mangësia e mendjes. Vërtetë Allahu i përmbush çështjet përmes shkaqeve që i paraprijnë ato, e nëse dëshiron Allahu, shkakut mund t’ja heqë tiparet e tij, e kështu që nuk ka ndikim dhe nuk sjell gjë. Shembull për këtë, kemi zjarrin që Allahu e ka bërë djegës, dhe kur populli i Ibrahimit e hodhën Ibrahimin në zjarr që ta digjin, Allahu i tha zjarrit:

كوني برداً وسلاماً على إبراهيم

“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” [El Enbija’: 69].

E kështu zjarri u bë i ftohtë, u bë shpëtim dhe nuk e dogji Ibrahimin, dhe as që e dëmtoi.

Mirëpo ka prej njerëzve që i ruhen të keqes përpara se e keqja të bjerë, ose mundohet ta largojë të keqen pasi i ka rënë, përmes shkaqeve të ndaluara; e prej këtyre janë lidhja e rrethit (apo byzylykut) dhe e perit, varja e nuskave tek njerëzit, tek kafsha, tek mjeti i udhëtimit apo në shtëpi.

Kush i varë këto nuska, është njëri prej dy personave:

Ose beson se këto hajmali dhe nuska e largojnë ato vetë të keqen, me fuqinë dhe tiparet e tyre; e kjo është shirk i madh që të nxjerrë nga Islami, sepse i ka shoqëruar ortak Allahut; beson se ajo ai posedon dëmin dhe dobinë.

Ose beson se këto (hajmali dhe nuska) janë shkaqe dhe bëjnë dobi me lejen e Allahut; kjo është shirk i vogël, dhe njeriu është në rrezik të madh, mirëpo ai nuk del nga Islami.

Vërtetë kanë ardhur argumentet nga Kurani dhe Suneti të cilat paralajmërojnë nga varja e nuskave, sido dhe të çfarë do lloji të jenë; qofshin ato hajmali, pupla, lëkurë, gjallesa të tokës apo ujit, penj, metale apo të tjera gjëra.

Bile tek argumentet e përgjithshme bëjnë pjesë edhe varja e Kuranit dhe haditheve me qëllim të mbrojturit nga të këqijat, apo largimin e tyre; e ky është mendimi i një grupi të sahabëve.

Prej argumenteve që kanë ardhur lidhur me këtë temë, është hadithi i Imran ibën Husajnit, se Pejgamberi *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* ka parë një burrë, dhe në dorën e tij kishte një rreth metalik (ngjyrë verdhë), dhe i tha: “Çfarë është kjo?”, ai tha: “Kjo është për sëmundjen e krahut.” Ai tha:

انزعها فإنها لا تزيدك إلا وهنا فإنك لو مت وهي عليك ما أفلحت أبدا

“Hiqe atë, sepse vërtet ajo ta shton sëmundjen. Vërtet nëse ti do të vdisje me atë (në dorë), nuk do të shpëtoje kurrë.” E transmeton Ahmedi.

Vërtetë Pejgamberi *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* ka refuzuar (dhe qortuar) këtë person i cili kishte varur një rreth për shkak të sëmundjes që e kishte goditur dhe ia kishte dobësuar dorën, ai e urdhëroi që ta heqë atë me ashpërsi dhe me të shpejtë. Më pas, ai e lajmëroi se po të kishte vdekur pa u penduar prej saj, nuk do të kishte shpëtuar dhe përfundimi i tij do të ishte Zjarri, *nel ijadhu bil-lah*.

Nga Ukbeh ibën Amir, se Pejgamberi *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* ka thënë:

من تعلق تميمة فلا أتم الله له ومن تعلق ودعة فلا ودع الله له

“Kush varë një nuskë, Allahu mos ia përmbushtë, e kush varë guaskë, Allahu mos e rehatoftë.” Dmth, kush e lidhë zemrën e tij pas një nuske, Allahu mos ia plotësoftë dëshirën apo kërkesën. E kush varë guaskë, Allahu mos i dhëntë qetësi, rehati dhe prehje. Pejgamberi *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* bën dua kundra këtij personi si ndëshkim për veprën e shirkut që ka ndërmarrë; vepër e cila e kundërshton teuhidin dhe singëritetin për Allahun.

Pejgamberit *sal-LAllahu alejhi ue sel-lem* iu drejtua një grup njerëzish për t’i dhënë besën, dhe ai ia mori besën nëntë prej tyre, ndërsa ndaloi tek i dhjeti. Atij i thanë: o i Dërguari i Allahut! I more besën nëntë vetëve, dhe nuk ia more këtij? Dhe tha: “Vërtetë ai ka varur një nuskë.” E futi dorën, e këputi (nuskën), ia mori besën e më pas tha:

“Kush varë një nuskë, vetëm se ka bërë shirk.”

Dmth se ka bërë shirk të madh, nëse ai beson se nuska në vetvete e largon të keqen, dhe ka bërë shirk të vogël nëse beson se është shkak për largimin e të keqes. Allahu nuk e ka bërë (nuskën) shkak, bile ka ndaluar prej saj dhe e ka konsideruar atë prej shirkut.

Një herë Hudhejfja *radijAllahu anhu* hyri tek një i sëmurë, dhe tek krahu i tij vërejti disa rrathë, e më këtë rast ai i këputi dhe i hoqi, më pas shtoi:

وما يؤمن أكثرهم بالله إلا وهم مشركون

“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.” [Jusuf: 106].

Dmth, shumica e tyre nuk besojnë në Allahun si Zot, pa i bërë Atij në adhurim shirk të madh apo të vogël. Të pakët janë njerëzit që e përmbushin teuhidin.

Sa mirë që ka bërë Hudhejfja duke e shpëtuar këtë të sëmurë nga kjo vepër e shirkut, e cila gati sa nuk e shkratërroi.

Transmeton Uekiu nga Said ibën Xhubejri *rahimehullah*, se ka thënë:

“Kush e këput një nuskë nga një njeri, është sikur të ketë liruar një rob.”

Dmth, ai i cili e këput një nuskë nga një njeri, shpërblimi i tij është sikur i atij që ka liruar një rob.

Kush shikon një të keqe – sidomos lidhur me teuhidin – duhet të shpejtojë në kundërshtimin e tij, sipas mundësisë dhe rregullave fetare;

sepse heshtja nga kundërshtimi (i të keqes) dhe nga sqarimi, bëhet shkak për përhapjen e të keqes dhe veprimit të tyre nga ana e njerëzve.

Allahu më bekoftë mua dhe ju me Kuranin Madhështor, dhe më sjellë dobi mua dhe ju me udhëzimin e zotëriut të peygamberëve. Them këto fjalë, dhe i kërkoj Allahut Madhështor falje nga çdo gjynah për mua dhe ju, gjithashtu edhe kërkojini falje, vërtet Ai është Pendimpranuesi, Mëshirëploti.

Hutbeja e dytë:

Vërtetë të lidhurit pas nuskave është prej çështjeve dhe karakteristikave të injorancës, pas të cilave me keqardhje të madhe, disa njerëz vazhdojnë të lidhen pas tyre. Vërtetë Sheriati – sikurse dëgjuam – i ka luftuar dhe ka ndaluar prej tyre. Të gjithë muslimanët e kanë për detyrë që t'i braktisin ato, të heqin dorë, të prishin (çdo nuskë) dhe të ruhen nga mashtrimet që Shejtani i bën mendjeve dhe njerëzve. Po të ishte diçka e mirë, Sheriati do të drejtonte drejt saj.

Ka prej njerëzve, të cilët Shejtani i ka pështjelluar përmes përvojës (apo përjetimit); dhe vëren një person që thotë: Filani vari nuskë dhe u shërua, ndërsa filani që nuk e vari nuskën, nuk u shërua. Ndërsa një tjetër thotë: Foshnjës së parë nuk ia varëm dhe vdiq, nuk ia varëm foshnjës së dytë dhe vdiq, ndërsa foshnjës së tretë ia varëm dhe jetoj. E kështu me rradhë; historitë janë të shumta.

Prej çështjeve që duhet patur vëmendje, është se përvojat (apo përjetimet), nuk lejohet të merren për argumente që kundërshtojnë argumentet e Sheriatit, mirëpo këto histori, nëse janë të sakta, bëjnë

pjesë tek sprovimi që Allahu i bën robëve të Tij, në mënyrë që të bëhet e qartë se kush qëndron në Rrugën e drejtë, dhe kujt i rrëshqet këmba për në Rrugën e banorëve të Zjarrit.

Prej nuskave të përhapura, janë varja e lëkurës së ujqëve, varja e syrit blu të vizatuar, varja e leckave të zeza në makina, vendosja e Kuranit në makinë për ta mbrojtuar atë, shkrimi i disa dhikreve nëpër shtëpi dhe të tjera forma të nuskave që janë të përhapura. E lusim Allahun t'i pastrojë shoqëritë tona prej tyre, vërtetë Ai është Bujar.

O besimtarë! Dërgoni salavat dhe selam mbi të dërguarin mëshirë për krijesat. O Zot lavdëroje tek melaiket e lartë dhe bekoje robin dhe të Dërguarin tënd Muhamed, familjen, halifët e tij të udhëzuar, sahabët në përgjithësi dhe ata që i pasuan me mirësi deri në Ditën e Gjykimit, dhe neve bashkë me ta, o më Bujari ndër bujarët.

O Zot lartësoje Islamit dhe muslimanët, nënçmoje shirkun dhe idhujtarët.

O Zot na bëj të sigurtë në shtëpiat tona, dhe ndreqi prijësit dhe kryetarët tanë.

O Zot jepi sukses prijësit tonë, ndihmoje me ndihmën Tënde. O Zot jepi atij një shoqëri të mirë dhe këshilluese e cila e drejton drejt të mirës dhe e ndihmon në të, përmes mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi ndër të mëshirshmit.

Zoti ynë na jep në këtë botë të mira, na jep në botën tjetër të mira dhe na mbrojt nga ndëshkimi i Zjarrit.

O Zot fal muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtaret, ata që janë gjallë dhe ata që kanë vdekur.

I lartësuar qoftë Zoti yt, Zoti i Madhështisë e i Lavdisë, mbi çfarë i veshin ata! Ruajtja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarit, dhe të gjitha lavdet e falënderimet qofshin për Allahun, Zotin e botëve!

Burimi nga është marrë hytbeja:

[http://www.haddady.com/ra_page_views.php?id=284&page=16
&main=5](http://www.haddady.com/ra_page_views.php?id=284&page=16&main=5)

Përktheu: Besmir Cacani

Lexoi dhe kontrollloi: Emin Ago

